



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVES
VRHOVNI SUD KOSOVA- SUPREM CORT KOSOVO

ANALIZË E POLITIKËS NDËSHKIMORE NË RASTET E KORRUPSIONIT

Prishtinë 2019

I. HYRJE E PËRGJITHSHME

Pas miratimit të Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore, nga ana e Seancës së Përgjithshme të Gjykatës Supreme në shkurt të vitit 2018, është themeluar Komisioni Këshilldhënës për Politikën Ndëshkimore me qëllim të monitorimit të trendeve në politikën ndëshkimore në Kosovë.

Gjatë vitit 2018 në tërë Kosovën janë mbajtur 12 tryeza me mbështetjen e Ambasadës Amerikane. Tryezat janë fokusuar në prezantimin e parimeve të matjes së dënimit sipas Udhëzuesit të miratuar. Pjesmarrës në këto tryeza kanë qenë gjyqtarë dhe prokurorë të të gjitha niveleve, kryetarë të gjykatave dhe krye-prokurorë, avokat, mbrojtës të viktimave dhe zyrtarë tjerë ligjor të gjykatave dhe prokurorive.

UNDP poashtu ka afruar mbështetje për Komisionin duke angazhuar asistent ligjor për të ndihmuar në përcjelljen dhe analizimin e lëndëve të korrupsionit. Gjithashtu, me qëllim të familjarizimit me praktikat më të mira në matjen e dënimit, UNDP ka sponsorizuar vizitën studimore të anëtarëve të Komisionit në Britaninë e Madhe. Anëtarët e Komisionit patën mundësinë të takohen me anëtarët e Komisionit të B.M për Politikë Ndëshkimore.

Ky raport paraqet dokumentin e parë të përgatitur nga Komisioni dhe ka për qëllim:

- Të jap një pasqyrim të përgjithshëm bazuar në vendimet e marra gjatë vitit 2018 nga gjykatat e të gjitha instancave në veprat që ndërlidhen me korrupsion; dhe
- Të jap një analizë më të detajuar mbi trendet në matjen e dënimit në rastet e korrupsionit bazuar në analizën e 27 lëndëve të zgjedhura rastësisht.

II. PASQYRIM I PËRGJITHSHËM PËR TRAJTIMIN E LËNDËVE TË KORRUPSIONIT PËR 2018

Tabela e mëposhtme paraqet një pasqyrim të përgjithshëm vetëm mbi mënyrën e zgjidhjes së lëndëve të korrupsionit të trajtuara nga gjykatat themelore në tërë Kosovën. Tabela nuk përmban detaje të lartësisë së dënimit. Kjo për faktin se Komisioni Këshilldhënës për Politikën Ndëshkimore është themeluar nga mesi i vitit 2018 dhe nuk ka pasur në dispozicion mekanizmat për të përcjellë vendimmarrjen nga ana e gjykatave.

2018	Nr. i lëndëve të zgjidhura	Aktgjykim me burgim	Dënim me gjobë	Dënim Alternativ	Aktgjykim Lirues	Aktgjykim Refuzues	Pushim i procedurës
Prishtinë	86	10	14	18	20	8	16
Ferizaj	8	1		4	2	1	
Prizren	24	5	4	6	6	1	2
Gjakovë	20	1	3	4	5	1	6
Gjilan	40	4	5	4	22	2	3
Mitrovicë	10		5	1	3	1	
Pejë	16	1	2	3	5	2	3
gjithsejt	204	22	33	40	63	16	30

Fig.nr.1

Tabela e mëposhtme përfshin statistikat nga Gjykata e Apelit për vitin 2018 për trajtimin e rasteve të korrupsionit:

NENI	Hudhje e ankesës	Vendimi i shkallës së parë:				
		Është vërtetuar	Është abroguar	Ashpërsim i dënimit	Zbutje e dënimit	Ndryshuar për arsye tjera
	2	69	23	1	3	9
422/339	2	47	16	0	0	6
423	0	2	0	0	0	0
424	0	1	0	0	0	0
425/340	0	3	4	0	0	0
426/341	0	2	1	0	0	1
428/343	0	7	1	1	2	1
429/344	0	3	0	0	0	1
431/345	0	1	0	0	1	0
432/346	0	1	0	0	0	0
433/347	0	1	0	0	0	0
434/348	0	1	1	0	0	0

Fig.nr.2

Tabela në vijim përfshin të dhëna për trajtimin e lëndëve të korrupsionit nga ana e Gjykatës Supreme për vitin 2018:

Raport vjetor për lëndët e korrupsionit për periudhën 01.01.2018-31.12.2018	Të aprovuara	Të refuzuara	Të hedhura poshtë	Gjithesëj
	7	10	3	20

Fig.nr.3

III. ANALIZË E 27 LËNDËVE TË KORRUPSIONIT

Me qëllimin që të kuptohet më mirë procesi i përdorur nga gjykatat në llogaritjen e dënimit, Komisioni Këshilldhënës për Politikën Ndëshkimore analizoi 27 vendime gjyqësore të zgjedhura rastësisht nga lëndët e korrupsionit nëpër gjykatat e ndryshme në Kosovë. Raporti përfshinë vendimet e të gjitha tri niveleve të gjykatave në lëndët e zgjedhura rastësisht kur vendimet e tilla ishin në dispozicion. Nga këto 27 raste, për 32 persona gjykatat kanë shpallur aktgjykime dënuese.

Gjatë analizës Komisionit është përqendruar në çështjet si në vijim:

- Dënimet e shqiptuara;
- plotësuese të shqiptuar;
- Rrethanat lehtësuese dhe rënduese të përfshira në 27 lëndët e analizuara;
- Aplikimi i dënimit me kusht;
- Krahasimi i veprave të ngjashme dhe dënimet përkatëse të shqiptuara;
- Analiza e arsytimit të dhënë për përdorimin e rrethanave lehtësuese në veçanti kur dënimi i shqiptuar është nën minimumin e paraparë me ligj.

Analiza synon që ta adresojë secilin prej këtyre rrethanave dhe i paraqet rekomandimet për përmirësimin e performancës së përgjithshme në lidhje me shqiptimin e dënimeve. Në përgjithësi, këto lëndë janë gjykuar para miratimit të Udhëzuesit për Shqiptim të Dënimeve në shkurt të vitit 2018 dhe kështu qasja e kësaj analize është që përgjithësisht ta pasqyrojë politikën ekzistuese ndëshkimore në Kosovë dhe nuk bëhet asnjë referencë nëse gjykatat e ndryshme janë në përputhje apo jo të parimeve të Udhëzuesit.

IV. ANALIZA E LËNDËVE SPECIFIKE

Komisioni ka identifikuar dhe ka përdorur si mostër për qëllim të analizës gjithsej 27 lëndë të korrupsionit për shkeljet e kryera sipas nenit 56 të Ligjit për Pastrimin e Parave¹, dhe neneve 422, 425, 428, 433, 435 dhe 437 të KPRK. Të pandehurit e përfshirë në këtë analizë përfshijnë zyrtarë në pozita të nivelit ulët, të mesëm dhe të lartë. Përgjithësisht dënimet e shqiptuara për këto vepra penale nga gjykatat e shkallës së parë variojnë nga 6 deri në 60 muaj. Tabela nr.4 i tregon dënimet për nenet përkatëse.




Fig.nr.4

Diagrami i mëposhtëm ka për qëllim të shfaq përqindjen për llojet e dënimeve të shqiptuara në lëndët e analizuara.




Fig.nr.5

¹ Neni 56, Vepra penale e pastrimit të parave, Ligji Nr.05/L-096, për Parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 15 qershor 2016.

a. Shqiptimi i dënimit me kusht

Gjithsej tetë (8) të pandehurve u shqiptuan dënime me kusht. Dëmi i specifikuar në këto lëndë përfshinte pasurinë deri në 65,000.00 €; Shih tabelën nr.6 më poshtë:

Nenet përkatëse	Profesioni	Dënimi dhënë në muaj	Dënimi me kusht
422.1	Zyrtar i policisë	10	Po
422.1	Kryetar i Komunës	10	po
437	Punonjës publik	6	po
422.1	Menaxher i fabrikës	12	po
422.1&2.1, 2.2	Drejtor Komunal i Arsimit	12	po
422.1	Punonjës i fabrikës	12	Po
422.1 & 2.4	Kryetar i Shoqatës	12	Po
33 i lidhur me 428.1	Kontabilist	8	Po

Fig.nr.6

b. Shqiptimi i dënimit plotësues

Në 9 (nëntë) lëndë, gjykata nxori dënim plotësues për ndalimin e funksionit publik. Vetëm 3 (tre) prej të pandehurve në këto lëndë hynë në Marrëveshjen e Pranimit të Fajësisë. Shih tabelën nr.7 më poshtë:

Profesioni	Neni	Dënimi plotësues	Marrëveshja për pranimin e fajësisë
Zyrtar i Prokurimit	428.1	1 vit ndalim i punës në adm.publike	po
Kryeinspektor	428.1	3 vjet ndalim në ushtrim të funksionit	po
Zyrtar i Kompanisë	425.2	3 vjet ndalim i profesionit	po
Drejtor i Dr. së Urbanizmit	428.1	2 vit ndalim i punës në adm. publike	jo
Punonjës në ndërmarrje pub.	425.1	2 vjet ndalim i profesionit	jo
Drejtor Komunal i Arsimit	422.1& 2.1, 2.2	2 vjet ndalim i profesionit	jo
Kryetar i Shoqatës	422.1 & 2.4	2 vjet ndalim i profesionit	jo
Inspektor tatimor	428.1	2 vit ndalim i punës në adm. publike	jo
Ish gjyqtar	432, 422,56	3 vit ndalim i punës në administratën publike si avokat	jo

Fig.nr.7

c. Vendimi mbi çështjen e dëmshpërblimit

Në 8 (tetë) lëndë, të pandehurit në lëndët e keqpërdorimit të autoritetit zyrtar dhe rryshfetit u urdhëruan që ta dëmshpërblejë palën e dëmtuar.

Nenet përkatëse	Dëmi i shkaktuar	Profesioni	Dëmshpërblimi
432, 422, 56 ²	1,200,000.00€	Ish-gjyqtar	Rikthim i palujtshmërive
425.2	33,488.00€	Zyrtar i Kompanisë	25,061.79 €
422.1	2,394.35€	Zyrtar komunal	Dëmshpërblimi i plotë
428.1 & 81	4,500.00€	Menaxher në Ndërmarrje Publike	Dëmshpërblim i plotë
425.1&2 &31	10,711.16€	Referent në Institucion Fin.	Dëmshpërblim i plotë
425.1	3,033.98€	Punonjës i kompanisë	Dëmshpërblim i plotë
343.1 ³	1,000 € (janë kërku edhe 10,000 €)	Punonjës i QPS-së	Dëmshpërblim i plotë
D#1: 428.1; D#2&3:431.1, 31	22,000.00€	Prokuror dhe dy të pandehur tjerë	Dëmshpërblim i plotë i caktuar për tre të dënuarit

Fig.nr.8

Të paktën në dy nga lëndët ku të pandehurit u shpallën fajtorë për keqpërdorim të autoritetit zyrtar, palët e dëmtuara u këshilluan që ta kërkonin dëmshpërblimin në procedurë civile. Dëmi i shkaktuar në këto vepra ishte 51,267.78 € për lëndën e parë dhe 14,319.16€ për lëndën e dytë. Të dyja lëndët u konfirmuan nga Gjykata e Apelit ndërsa Gjykata Supreme e dërgoi të dytën në rigjykim.

² Neni 56, Vepra penale e pastrimit të parave, Ligji Nr.05/L-096, për Parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 15 qershor 2016

³ Kodi i përkohshëm penal i Kosovës, UNMIK/RREG/2003/25, I dates 6 korrik 2003.

V. VARIACIONET NË SHQIPTIM TË DËNIMEVE SIPAS NENIT TË NJËJTË

A. Keqpërdorimi i autoritetit zyrtar nga neni 422

Sipas nenit 422 të Kodit Penal në fuqi, dënimi i paraparë është 6 muaj deri në 5 vjet. Si pjesë e kësaj analize rezulton se përgjithësisht dënimet variojnë nga 6-18 muaj. Sidoqoftë, për ta bërë një analizë të plotë të dënimeve të shqiptuara, ekziston nevoja për të vlerësuar çështje tjera që kanë të bëjnë me shqiptimin e dënimit, si niveli i dëmit, caktimi i dëmshpërblimit dhe nëse gjykata ka urdhëruar dënim plotësues. Për të filluar me këtë analizë, më poshtë e kemi dhënë një tabelë të dënimeve kryesore të shqiptuara dhe profilin e personave të dënuar:




Fig.nr.9

Gjashtë nga të pandehurit në këtë kategori morën dënime me kusht ndërsa dënimi për njërin prej tyre u konvertua vetëm në gjobë. Vetëm në dy prej këtyre lëndëve gjykata nxori dënim plotësues me 2 vjet ndalim të ushtrimit të profesionit.

Për qëllim të krahasimit të ashpërsisë së veprës së kryer dhe si u reflektua ajo në dënimin e formës së prerë, ne do ta marrim shembullin e dy të pandehurve që e keqpërdorën autoritetin e tyre zyrtar si zyrtarë policorë. Qëllimi i këtij krahasimi është ritheksimi se ashpërsia e veprës varet jo vetëm nga lartësia e dëmit të shkaktuar, i cili në shikim të parë mund të konsiderohet minimal në këto dy lëndë, por më shumë në rrezikun shoqëror të veprës së tillë që shpesh mund të jetë shumë më i rëndë sesa dëmi material i lidhur me veprën:

• Lënda# PKr.292/16, Zyrtari shpallet fajtor për veprën nga neni 422 paragrafi 1

Specifikat e rastit: I pandehuri është zyrtar kufitar dhe ka kërkuar favore të ndryshme (të tilla si para, kredi telefoni, etj.) në këmbim të mundësisë për të transportuar mallra dhe të mos ndalohej gjatë transportimit të mallrave në kufi.

• **Lënda#PKr.88/15 Zyrtari shpallet fajtor për veprën nga neni 422 paragrafi 1 dhe 2.1, 2.2 dhe 2.3 (vepra penale në vazhdimësi)**

Specifikat e rastit: I pandehuri e ndryshoi tiketën e trafikut për skadimin e regjistrimit të automjetit, duke e ndihmuar të pandehurin që transportonte dru zjarri të paligjshëm për ta shmangur patrullën e policisë dhe në fund për t'i marrë drurët për vete, duke e fshehur urdhërpagesën gjersa ta arrijë parashkrimin.

Përmbledhje për të dy veprat: Gjykata ishte shumë e butë ndaj dy të pandehurve duke u dhënë dënim me kusht të pandehurit të parë dhe dënim me 6 muaj burg të konvertuar në gjobë të pandehurit të dytë. Asnjë prej zyrtarëve nuk iu shqiptua dënimi plotësues për t'iu ndaluar ushtrimin e detyrës.

Rrethanat lehtësuese të shqyrtuara me rastin e shqiptimit të dënimit të pandehurit të parë ishin sjellja e tij korrekte në gjykatë, fakti se ai ishte babai i katër fëmijëve dhe nuk ishte i dënuar më parë. Gjykata gjithashtu konsideroi se edhe pse fitimi i të pandehurit ishte shumë i ulët (kishte përfituar 3 metra dru) pesha e kësaj rrethane ishte minimale duke pasur parasysh rrethanën rënduese të keqpërdorimit të autoritetit zyrtar dhe mënyrën në të cilën ishte kryer vepra duke ia mundësuar personave të tjerë që të përfitojnë.

Është e qartë në të dyja rastet se vepra nuk paraqiste një veprim të izoluar. Përshkrimi i veprës përfshinte një sërë veprimesh me të cilat të pandehurit keqpërdorën, në formë të ndryshme, autoritetin e tyre zyrtar që tregon qartë modelin e keqpërdorimit të pushtetit të cilin ata kishin aplikuar. Përveç kësaj, asnjë prej të pandehurve nuk e pranoi fajësinë dhe nuk hyri në marrëveshje për pranimin e fajësisë që mund të jetë tregues i qartë i mungesës së pendimit.

B. Vepra penale e Marrjes së Ryshfetit nga neni 428

Vepra penale e marrjes së ryshfetit konsiderohet shumë e rëndësishme për qëllime të analizës dhe dënimi i paraparë për këtë vepër është 6 muaj deri në 5 vite. Kjo është një nga veprat më të vështira për t'u dëshmuar, pasi në shumë raste të dyja palët, njëra që jep dhe tjetra që merr ryshfet, kanë pasur interes nga vepra. Për shkak se dhënia e ryshfetit është gjithashtu e dënueshme sipas Kodit Penal, personi që jep ryshfet është gjithashtu hezitues në raportimin e veprës së tillë ose sigurimin e provave që do të çonin në suksesin e lëndës. Tabela e poshtme i liston dënimet e nxjerra në lëndët kur të pandehurit janë shpallur fajtorë për veprën penale të marrjes së ryshfetit dhe profilin e të pandehurve:




Fig.nr.10

Siç shihet nga tabela e mësipërme, dënimi në gjykatën e shkallës së parë varion nga 6 - 60 muaj dhe përfshinë të pandehur në nivele të ndryshme të detyrës dhe të menaxhimit. Ndërkaq, në tabelën e mëposhtme janë listuar të njëjtat dënime por me një shpjegim më të zgjeruar rreth rasteve:

Nenet relevante	Profesioni	Dëmi i shkaktuar	Marrëveshje pranimit të fajësisë	Dënimi në muaj	Gjobë	Dënim plotësues
428.1	Drejtor i urbanizmit	€ 5,000.00	jo	12	€ 2,000.00	2 vjet ndalesë
428.1 & 81	Menaxher në Ndërmarrje Publike	€ 4,500.00	po	6	€ 2,000.00	nuk ka
428.1	Zyrtar policor	€ 10.00	jo	6	€ 500.00	nuk ka
343.1 ³	Punonjës i QPS	1,000 (kërkohen edhe 10,000€)	jo	6	0	nuk ka
428.1	Zyrtar ministror	500.00 €	jo	6	0	nuk ka
428.1	Prokuror	22,000.00 €	jo	36	€ 5,000.00	nuk ka
428.2	Elektricitist	500 €	jo	39	€ 1,000.00	nuk ka
428.1	Profesor	220.00€+150ChF	jo	6	€ 500.00	nuk ka
428.1	Inspektor	2,000.00 €		10	€ 500.00	2 vjet ndalesë
428.1	Zyrtar i prokurimit	1,500.00€ (100.000€ vlera e kontratës)	po	9	€ 400.00	1 vjet ndalesë
428.2	Zyrtar policor	300.00 €	jo	60	€ 1,000.00	nuk ka
428.1	Kryeinspektor	1,000.00 €	po	10	€ 2,000.00	3 vjet ndalesë

Fig.nr.11

VI. RRETHANAT LEHTËSUERE DHE RËNDUESE QË JANË MARRË PARASYSH ME RASTIN E SHQIPTIMIT TË DËNIMIT

Më poshtë është paraqitur një analizë për përdorimin e rrethanave të ndryshme lehtësuese dhe rënduese në rastet e analizuara dhe për ta diskutuar relevancën e tyre. Rrethanat e listuara kryesisht vetëm janë përmendur në vendim, por në përgjithësi, me pak përjashtime, pesha e tyre në kalkulimin e dënimit nuk është shpjeguar.

A. Rrethanat rënduese

Rrethanat rënduese të cilat janë marrë parasysh në këto vepra përfshijnë:

- Dëmtimin e reputacionit të shtetit;
- Mënyra dhe rrethanat e krimit;
- Shkalla e përgjegjësisë penale;
- Rreziku shoqëror;
- Dashja;
- Dënimi i mëparshëm;
- Humbja e kredibilitetit/besimit të publikut;
- Recidivist.

Në 8 (tetë) lëndë, gjykata nuk e listoi asnjë rrethanë rënduese. Në përgjithësi, të gjitha rrethanat e mësipërme konsiderohen të rëndësishme për këtë kategori të veprave. Veprat e korrupsionit dhe ato që ndërlidhen me to, duke e marrë parasysh se kryesisht kryhen nga personat me autorizime zyrtare, siç theksohet edhe në disa nga vendimet e gjykatës, po e dëmtojnë besimin e publikut në institucion dhe kështu meritojnë më shumë vëmendje edhe gjatë matjes të dënimit.

B. Rrethanat lehtësuese

Rrethanat më të cituara lehtësuese në rastet e analizuara ishin:

- Sjellja korrekte e të pandehurit;
- Gjendja martesore;
- Fakti që i pandehuri ka fëmijë;

Rrethanat tjerat përfshijnë:

- Gjendja financiare;
- Mbajtës i vetëm i familjes
- Kryes për herë të parë;
- Moshë (qoftë e re apo e vjetër);
- Aftësi të kufizuar fizike;
- Gjendja shëndetësore;
- Pendimi (që në disa raste është përfshirë si rrethanë jashtëzakonisht lehtësuese);
- Dëmi dhe/ose përfitim më i vogël për të pandehurin.

Sjellja korrekte e të pandehurit është përdorur në të gjitha lëndët e listuara. Ajo që është interesante është fakti se sjellja korrekte para gjykatës është renditur si rrethanë lehtësuese për një të pandehur megjithëse

rrethanat rënduese në të njëjtën lëndë thonë se i pandehuri ka përdorur gjuhë fyese ndaj kolegëve dhe institucioneve.

Është e rëndësishme që të theksohet (vetëm për qëllimin e përmbajtjes së arsytimit) se në një rast, edhe pse gjykata e konsideroi si rrethanë lehtësuese përfitimin e ulët nga i pandehuri, megjithatë gjyqtari në fakt e krahasoi vlerën e rrethanës lehtësuese si të parëndësishme gjatë peshimit në kalkulimin e dënimit duke marrë parasysh rrethanën rënduese të shkallës së dëmit të shkaktuar, pasi i pandehuri e keqpërdori autoritetin e tij si zyrtar policor dhe si i tillë ndikoi në humbjen e besimit të publikut në institucion.

Në dy nga lëndët e analizuara gjykatat kanë theksuar moshën e të pandehurit si rrethanë lehtësuese, respektivisht moshën e vjetër (66 vjeq) dhe moshën e re (37 vjeq). Kjo tregon se gjykatat nuk kanë qartësisht të definuar se si faktori moshë aplikohet në zbutje. Konsiderata e moshës 37 vjeçare si moshë të re për keqpërdorimin e detyrës zyrtare nga një punonjës i fabrikës i cili e keqpërdori pozitën e tij për të përfituar personalisht për afërsisht 14,000 € vën në pikëpyetje arsyeshmërinë e përfshirjes së kësaj rrethane. Në rastin e dytë kur mosha 66 vjeçare është marrë parasysh si rrethanë lehtësuese, gjykata njëkohësisht ka marrë parasysh rrethanën se i pandehuri është baba i 4 fëmijëve. Logjikisht, mund të konsiderohet se fëmijët e tij tashmë do të jenë të rritur dhe janë të aftë për të qenë financiarisht të pavarur. Pyetja e paraqitur në këtë rast do të ishte nëse gjykata ka ndërmarrë ndonjë përpjekje për ta konstatuar nëse i pandehuri ka 'fëmijë vartës' ose ky është pak a shumë një zbatim automatik i rrethanave lehtësuese?

Me përjashtim të dy situatave ku gjykata theksoi në arsyetim se rrethanat lehtësuese të veçanta u përdorën si rrethanë të jashtëzakonshme lehtësuese, në shumicën e lëndëve rrethanat lehtësuese vetëm ishin listuar, por nuk u shpjeguan si duhet pse kishin ndikim kaq të madh në shqiptimin e dënimit minimal.

VII. SHQYRTIMI NGA GJYKATA MË E LARTË

Siç rezulton nga analiza në shumicën e lëndëve të analizuara (21 lëndë), Gjykata e Apelit e konfirmoi vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

E konfirmoi dënimin	21 lëndë		
E zbuti dënimin	3 lëndë	Nga 54 në 42 muaj Nga 12 në 6 muaj Nga 60 në 24 muaj	Nga 5000 € në 3000 € gjobë
E ashpërsoi dënimin	2 lëndë	nga 6 muaj në 12 muaj; dhe nga 6 në 18 muaj	
Ankesa nuk u pranua	1 lëndë		

Fig.nr.12

- **Në lëndën nr.248/13** Gjykata e zbuti dënimin **nga 5 në 2 vjet**. Arsyetimi për ta zvogëluar dënimin u bë në bazë të ri-kualifikimit të veprës penale nga 428.2 (i dënueshëm me 3-12 vjet) në 428.1 (i dënueshëm me 6 muaj deri në 5 vjet) me arsyetimin se është e padiskutueshme që i pandehuri në këtë rast (zyrtari i policisë) i mori 300 € ryshfet për të vepruar në përputhje me punën e jo siç theksohet në paragrafin 2 në shkelje të detyrës së tij. Gjykata e Apelit përveq rikualifikimit të veprës penale ka hequr nga konsiderata edhe disa rrethana rënduese të evidentuara nga Gjykata e shkallës së parë duke theksuar se të njëjtat paraqesin elemente të veprës penale.
- **Në lëndën nr.642/15** për veprat penale nga **nenet 432, 422 të KPRK dhe 56** të Ligjit mbi pastrimin e parave, Gjykata e zbuti dënimin për të pandehurin (ish-gjyqtar) **nga 54 muaj në 42 muaj**. Në marrjen e vendimit Gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë lehtësuese, duke konstatuar se nuk ka pasur pretendim në ankesë përkitazi me rrethanat lehtësuese.
- **Në lëndën 111/2016** për veprën penale nga **Neni 425.1** (i dënueshëm nga 6 muaj deri në 5 vjet), Gjykata e zbuti dënimin për të pandehurin (arkëtar në Kompani publike) **nga 1 vit në 6 muaj burgim dhe nga 2 vite ndalim të ushtrimit të profesionit në 1 vit ndalim**. Kjo Gjykatë ka konstatuar se Gjykata e instancës së 1rë drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit dhe në shqiptimin e dënimit me burg dhe atë plotësues, megjithatë e njëjta gjeti se ka vend që të njëjtit ti shqiptohet dënim më i ulët duke pasur parasysh sasinë e parave të përvetësuara dhe se me këtë dënim me të butë do të arrihet qëllimi i dënimit.

Në dy raste, Gjykata e Apelit i ashpërsoi dënimet:

- **Në lëndën nr. 1002/13** Gjykata ashpërsoi dënimin **nga 6 muaj në 18 muaj** për të pandehurin (Menaxher në Ndërmarrje publike) për veprën e marrjes së ryshfetit nga neni **428.1** (i dënueshëm nga 6 muaj deri në 5 vjet). Gjykata e Apelit ka konsideruar se rrethanat lehtësuese (të cilat i referoheshin kryesisht rrethanave personale të kryesit, pranimit të fajësisë dhe pendimit) krahasuar me mënyrën e kryerjes së veprës penale janë mbivlerësuar nga Gjykata e instancës së 1rë. Kjo Gjykatë ka konstatuar poashtu se as mbrojtja nuk ka arritur të gjejë ndonjë rrethanë konkrete lehtësuese që do të ndikonte në shqiptimin e dënimit më të butë.
- **Në lëndën nr.234/14**, Gjykata ashpërsoi dënimin **nga 6 muaj në 18 muaj** e dënoi të pandehurin (punonjës Ministror) për veprën e marrjes së ryshfetit nga neni **428.1** (i dënueshëm nga 6 muaj deri në 5 vjet),

duke e rikualifikuar veprën në nenin **428.2** (e dënueshme me 3-12 vjet). Gjykata nuk i arsyetoi rrethanat rënduese përveq rikualifikimit të veprës penale dhe vetëm theksoi se Gjykata e instancës së parë ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese.

Në 27 lëndët e analizuara, Gjykata Supreme ka vendosur si në vijim:

- Në 4 (katër) raste, lënda është dërguar në rigjykim;
- Në 1 (një) rast, është zbutur dënimi në 40 muaj nga 42 muaj sa kishte caktuar Gjykata e Apelit, respektivisht nga 54 muaj sa kishte shqiptuar Gjykata e instancës së parë. Për po të njëjtën lëndë Gjykata Supreme kishte kthyer në rigjykim vetëm pjesën që kishte të bënte me pretendimet për veprën penale pastrimi i parasë.
- Në 1 (një) rast Gjykata Supreme e ktheu lëndën që e konfirmonte të drejtën e të pandehurit për ankesë e cila fillimisht ishte refuzuar nga Gjykata e Apelit.
- Në 21 raste, Gjykata Supreme ka hudhur Kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

PËRFUNDIM

Vlen të përsëritet që Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore nuk përcakton një zgjidhje specifike të rastit. Megjithatë, arsyetimi i duhur i dënimit, përfshirë edhe mbështetja faktike përmes rrethanave të përfshira, peshimi i tyre dhe arsyetimi që mbështet dënimin e dhënë, është mandator në të gjitha rastet. Dështimi i gjykatës për të iu përmbajtur kësaj ka ndikim direkt në të drejtat e njeriut, ul profesionalizmin e gjyqësorit dhe dëmton besimin e publikut.

Nga analizimi i këtyre rasteve, Komisioni nxjerr si përfundim ekzistimin e çështjeve si në vijim dhe fuqishëm kërkon nga gjykatat ti përmirsojnë ato në të ardhmen. Gjersa këto vendime janë marr para publikimit të Udhëzuesit, megjithatë ato shërbejnë si shembuj shtesë dhe konkret të mangësive të cilat nëse veprohet sipas parimeve të Udhëzuesit mund të përmirsohen.

- Anjë nga rastet e analizuara nuk kanë treguar për ndonjë përpjekje të gjykatave për të spjeguar përmes fakteve në çfarëdo niveli të detajeve ekzistimi i rrethanave lehtësuese apo rënduese- ato thjeshtë vetëm janë listuar.
- Asnjë nga vendimet nuk tregojnë për përpjekje për të përcaktuar të vërtetën për rrethanat lehtësuese personale si p.sh.për të kërkuar dokumente shtesë apo prova për gjendjen financiare të pandehurit, se janë mbajtës të familjes/fëmijëve, gjendjen shëndetësore të tyre etj.
- Gjykatat duhet të peshojnë apo përshkruajnë rëndësinë e secilës rrethanë. Nëse një gjë e tillë nuk bëhet, atëherë rezultatet do të jenë joracionale. Psh. Krahasoni rastet si në vijim kur dënimi i paraparë ka qenë identik (6 muaj deri 5 vite):
 - 3 rrethana rënduese, 1 lehtësuese- dënimi 8 muaj burgim;
 - 4 rrethana rënduese, 4 lehtësuese- dënimi 8 muaj burgim (2 raste);
 - 1 rrethanë rënduese, 1 lehtësuese- dënimi 6 muaj dënim me kusht;
 - 0 rrethana rënduese, 3 lehtësuese- dënimi 8 muaj burgim;
 - 3 rrethana rënduese, 3 lehtësuese- dënimi 10 muaj dënim me kusht;

Është e pamundur të kuptohet se si një i pandehur mund të marr një dënim që është afër minimumit të paraparë me ligj, kur ka numër më të madh apo të barabartë të rrethanave rënduese krahasuar me ato lehtësuese. Vetëm dënimi i katërt me radhë më sipër (pa rrethana rëndues dhe 3 lehtësuese) do ti afrohej dhe arsyetonte dënim afër minimumit të paraparë me ligj. Nuk ka absolutisht asnjë arsyetim për dënimin e dhënë me 10 muaj dënim me kusht kur rrethanat lehtësuese dhe rënduese janë të barabarta. Analiza e mësipërme kërkon që edhe një herë fuqishëm të ritheksohet nevoja që në çdo rast matja e dënimit duhet të filloj nga pika startuese, në pajtim me parimet dhe udhëzimet e dhëna në Udhëzuesin për Politikën ndëshkimore e më pas të bëhet peshimi i rrethanave lehtësuese dhe rënduese relevante për atë rast.

- Sjellja korrekte, siq edhe është spjeguar në Udhëzuesin për politikën ndëshkimore, më së miri mund të thuhet se është rrethanë konfuze. Me rastin e përcaktimit të dënimit është bërë pjesë e terminologjisë së gjykatave pa specifikuar në asnjë rast se çfarë nënkupton në fakt kjo rrethanë e sidomos në rastet e korrupsionit të trajtuara në këtë raport. Paraqitja në gjykatë sipas ftesës, mos pengimi i procesit dhe trajtimi i tjerëve me respekt minimal janë obligime bazë të qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe nuk do duhej të meritonin shpërblim përmes uljes së dënimit. Natyrisht, përdorimi i kësaj rrethane është i lejueshëm,

por e njëjta duhet kuptuar drejtë dhe duhet përdorur në mënyrë të kufizuar. Fakti se secila gjykatë ka marr për bazë këtë rrethanë nënkupton se nuk është kuptuar drejtë, posaqërisht duke pasur parasysh se në një nga vendimet të pandehurit iu ka marrë parasysh kjo rrethanë edhe pse gjykata ka shënuar se i njëjti ka qenë fyes ndaj tjerëve gjatë procesit.

- Ka një mbështetje të tepruar në rrethanat personale të të pandehurit. Gjersa ato janë natyrisht relevante, rrethanat specifike personale nuk janë të listuara në Kodin Penal. Si të tilla, rrethanat të cilat nuk janë të listuara në Kod kërkojnë arsytim të shtuar nga gjykata.
- Dështimi për të përshkruar se si është më i përshtatshëm Dënimi me kusht ndaj atij me burgim. Gjykatat duhet të shpjegojnë qëllimin e dënimit me kusht, e që është se kërcënimi me dënim me burgim, është i mjaftueshëm për të pandehurin e caktuar në vend të dërgimit të tij në vuajtje të dënimit. Kjo është veqanërisht problematike kur të kemi parasysh se nuk ka pasur ndonjë dallim thelbësor në mes të situatave kur gjykata ka shqiptuar dënim me burgim nga situatat tjera kur gjykata ka shqiptuar dënim me kusht.
- Në një numër të rasteve gjykatat kanë listuar rrethana të cilat jo vetëm që nuk janë të parapara por as që meritojnë përfshirje në këtë natyrë të veprave. Këto janë:
 - Gjinia e të pandehurit;
 - Niveli i arsimimit;
 - Kalimi i kohës.

Analiza e dhënë në këtë raport qartazi tregon nevojën për të dhënë më shumë udhëzime për gjykatat në llogaritjen e dënimit por edhe për përdorimin e rrethanave relevante lehtësuese dhe rënduese gjatë matjes së dënimit. Njëkohësisht kjo analizë, tregon edhe për nevojën që prokurori, avokati mbrojtës dhe pala e dëmtuar me rastin e gjetjes dhe prezantimit para gjykatës të rrethanave rënduese dhe lehtësuese të fokusohen në mënyrë konkrete e jo vetëm parafrazuese në ato rrethana që janë relevante.

Komisioni Këshilldhënës për politikën ndëshkimore do të vazhdojë të monitorojë trendet në caktimin e dënimit dhe në raportet e ardhshme do të jetë më i detajuar në analizën e rasteve specifike dhe në nevojat specifike për përmirsim duke përfshirë edhe analizën më të detajuar mbi rolin e prokurorit dhe avokatit mbrojtës në prezantimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për gjykatën siq edhe kërkohet në një sistem të mirëfilltë akuzator.



Printed by:
United States Embassy in Pristina
U.S. DoJ / Office of Overseas Prosecutorial Development,
Assistance and Training (OPDAT)